



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4988 Prot.

Roskovec, më 29.09 2020

V E N D I M

NR 76 , DATË 28.09 .2020

“PËR MIRATIM FONDESH SHITESË NË BUXHETIN E BASHKISË ROSKOVEC PËR VITIN 2020

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“neni 54 gërma dh, të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjen vendore“neni 46 ,Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetore në RSH”i ndryshuar neni 47, të udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”,shkresave të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.16572 prot.datë 09.09.2020 “Ndarja e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale për NJQV për vitin 2020” dhe Nr.16737 datë 10.09.2020 “Mbi përdorimin e tatimit mbi të ardhurat personale”,VKB nr.116 datë 20.12.2019 “Për miratimin e buxhetit dhe numrin maksimal të punonjësve të Bashkisë Roskovec dhe ndërmarrjeve vartëse, si dhe nivelin maksimal të pagave për vitin 2020”,si dhe të materialeve të sjella nga Drejtoria e Kulturës,Arsimit,Shëndetsisë,Projekteve Sociale dhe Koordinimit me BE-në,dhe sektori i ndihmave ekonomike dhe paaftësisë,Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- I. Të miratojë fondin e të ardhurave prej **3,024,193** lekë nga “Tatim mbi të ardhurat personale për vitin 2020”
- II. Të miratohet detajimi i fondit të mësipërm për shpenzimet,si më poshtë vijon:

Shtohet :

1. **NJËSIA SHPENZUESE “BASHKIA ROSKOVEC”,KODI 2113001**

1.Gr.00 TIT. 09120 KAP. 05 ART.602 (shpenzime për materjale pastrimi dhe dezinfektimi në kopshte dhe shkollat e bashkisë) **960,000** lekë.

- 2.Gr.00 TIT.09120 KAP.05 ART.602 (shpenzime për mirëmbajtje të ambjenteve në kopshte dhe shkollat e bashkisë) **840,000** lekë
- 3.Gr.00 TIT.01110 KAP.05 ART.602 (shpenzime për masat kundër COVID-19 në administratën e bashkisë) **494,193** lekë

2. NJËSIA SHPENZUESE “NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE TË MIRËMBAJTJES” KODI 2113002

Të miratohet fondi i detajuar më poshtë për 2 punonjëse pastrimi me kohë të pjesshme (4 orë në ditë) për dy shkollat e qytetit Roskovec të cilat punojnë me dy turne nga masat e marra nga mbrojtja nga COVID-19 për nxënësit e këtyre shkollave:

				Viti 2020	Viti 2021	Shuma
1.	Gr.00	TIT.09120	KAP.05 ART.600	150,000	480,000	630,000
2.	Gr.00	TIT.09120	Kap.05 ART.601	30,000	70,000	100,000
			Shuma:	180,000	550,000	730,000

1. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike për zbatimin e këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Kadri Hyska

